



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 3121/prot.
1

Elbasan, më 04.12.2024

VENDIM

Nr 15 datë 04.12.2024

"PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, gërma "c" të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 9, gërma "c" të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"; Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 57 datë 3.12.2024 "Për miratimin paraprak të disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" me propozim të Rektoratit të bazuar në propozimin e Komisionit Ad-hoc, krijuar me Urdhrin e Rektorit nr. 186, datë 11.11.2024, "Për Krijimin e Komisionit Ad-hoc për Rishikimin e Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

VENDOSI:

- I. Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", si më poshtë:
 1. Shfuqizimin e gërmës (d) pika 1 e nenit 42.
 2. Shfuqizimin e gërmës (d) pika 1 e nenit 43.
 3. Shtimin e nenit 45/1 të titulluar "Pezullimi i marrdhënieve të punës" pas nenit 45 "Përfundimi i marrdhënieve të punës". Neni i propozuar 45/1 "Pezullimi i marrdhënieve të punës" të ketë këtë përmbajtje:
 - 1) Marrdhënia e punës në UE, për të gjithë punonjësit e tij si: personel akademik me kohë të plotë dhe personel akademik me kohë të pjesëshme, personel ndihmësakademik dhe personel administrativ, pezullohet në rastet si më poshtë:
 - a) Gjykata ka vendosur një nga masat shtrënguese dhe/ose ndaluese të sigurimit personal si:
 1. Arrest në burg;
 2. Arrest në shtëpi;
 3. Pezullimin nga detyra;
 4. Shtimin e përkohshëm në një spital psikiatrik.
 - 2) Punonjësit të pezulluar nga detyra i ndërpriten marrdhëniet financiare për kohën e pezullimit.
 - 3) Pezullimi nga detyra përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit.
 - 4) Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" nuk mban përgjegjësi financiare për periudhën e pezullimit nga detyra.
 - II. Vendimi i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Elyira Fetahu

